



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:916087

Datë: 14.05.2024

Numri i dokumentit: 05700611

Ac.nr.346/2019

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Naime Ahmeti kryetare e kolegjit, Halide Reka dhe Adnan Konushevci, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Sh.A. nga Ferizaji, te cilën me autorizim e përfaqëson R.Sh. avokat nga Ferizaji, kundër të paditurve Sh. L., K., Z., dhe S.G., që të gjithë nga Ferizaji, të cilët me autorizim i përfaqëson A.D. avokat nga Ferizaji, dhe të paditurve Gj., V., L., V., dhe V.G., që të gjithë nga Ferizaji, të cilët me autorizim i përfaqëson S.K. avokat nga Lipjani, për shkak të vërtetimit të drejtës së pronësisë të fituar gjatë bashkësisë jashtëmartesore dhe ndarje të pasurisë së përbashkët, duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur nga i autorizuari i të paditurve av.A.D., dhe ankesës të autorizuarit të paditurve av.S.K. të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj –Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.367/2017, të datës 08.10.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 30.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.REFUZOHEN të pathemelta ankesa e të paditurve Sh., L., K., Z., dhe S.G., që të gjithë nga Ferizaji, dhe ankesa e të paditurve Gj., V., L., V., dhe V.G., që të gjithë nga Ferizaji, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj –Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.367/2017, i datës 08.10.2018, në pikën II (dy), dhe IV (katër) të dispozitivit, VËRTETOHET.

II. Pika I (një) dhe III (tre) e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.367/2017, të datës 08.10.2018, mbeten të pa shqyrtuara.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar C.nr.367/17, të datës 08.10.2018 në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit ka vendosur: VËRTETOHET se ngastra kadastrale me nr... ZK Ferizaj, evidentohet në emrin e V.G. nga Ferizaji, ne të cilën gjendet kafeneja në sip. 55 m², dhe aneksi(bilardi) në sip. 30 m², si dhe ½ e pasurisë së përbashkët e cila është fituar gjatë bashkësisë jashtëmartesore të paditëses me tani të ndjerin V.G., e cila përbëhet nga një lokal banesor e ndërtuar mbi kafenen në sipërfaqe prej 55 m², të cilën e përbëjnë dy dhoma, kuzhina dhe korridori, banjo dhe WC, pastaj shtëpia dy katëshe në vazhdim të kafenes e cila në katin përdhes ka 4 lokale afariste, një korridor dhe WC, dhe në katin e parë 3 dhoma, korridori, banjo me WC, të cilat palujtshmëri gjenden në Ferizaj, në rrugën "...", e ndërtuar me kontributin e përbashkët të paditëses dhe tani të ndjerit V.G. pastaj ng.kad.nr...-2 ZK P., Komuna Ferizaj, në sip. 670 m², në të cilën është e ndërtuar shtëpia P+1+NK, e cila evidentohet në emrin e V.G., si dhe ng.kad.nr... ZK Ferizaj, e cila është blerë nga i ndjeri V.G. dhe paditësja Sh.A. që në vitin 1985 me kontributin e përbashkët, që vërtetohet sipas deklaratës të ndjerit J.G., i cili ka deklaruar se kjo patundshmëri është blerë nga babai i tij, e cila kjo patundshmëri evidentohet në emrin e J.G., e fituar me aktgjykimin C.nr.260/01 të datë 22.10.2002, që paraqet bashkëpronësi e paditëses dhe si të tilla ndahen nga masa e trashëgimisë e tani të ndjerit V.G.. Në dispozitivin II e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses Sh.A. nga Ferizaji dhe janë obliguar të paditurit Sh., L., K., Z., dhe S.G., që të gjithë nga Ferizaji, dhe Gj., V., L., V., dhe V.G., që të gjithë nga Ferizaji, që paditëses në emër të kontributit të dhënë në bashkësinë jashtëmartesore me tani të ndjerin V.G., ti kompensojnë shumën e të hollave në vlerë prej 104,984.00 €, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë. Në dispozitivin III e ka refuzuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditëses, në shumë prej 209,969.00 €, në emër të kontributit të dhënë në bashkësinë jashtëmartesore, si të pabazuar. Në dispozitivin IV janë obliguar të paditurit që të bëjnë pagesën e shpenzimeve të procedurës për përpilimin e padisë shumë prej 208 €, për katër /4/ seancat e mbajtura nga 270 €, apo shumë prej 1,438.00 €, shpenzimet e ekspertit gjeodet shumë prej 200 €, si dhe për ekspertizën e ekspertit të palujtshëmëve shumë prej 350 €, apo shumë prej 550 €, gjithsejt shumë prej 1,988.00 €, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin e paraparë ligjor ankesë ka paraqitur i autorizuari i të paditurve Sh., L., K., Z., dhe S.G., që të gjithë nga Ferizaji, av.A.D. nga Ferizaji, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontesimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit të aprovoj si të bazuar ankesën e të paditurve, kurse aktgjykimin e atakuar, konform nenit 195.1 të LPK-së, ta ndryshojë dhe të vendos në mënyrë meritore.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin e paraparë ligjor ankesë ka paraqitur edhe i autorizuari i të paditurve Gj., V., L., V., dhe V.G., që të gjithë nga Ferizaji, av.S.K. nga Lipjani, për shkak të shkeljes të dispozitave të procedurës kontesimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit të aprovoj si të bazuar ankesën e të paditurve, kurse aktgjykimin e atakuar ta ndryshojë ashtu që të refuzoj kërkesëpadinë e paditëses ose aktgjykimi i atakuar të priset dhe çështja të kthehet në rivendosje.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditëses me përgjigje në ankesë, ka propozuar që ankesat e të paditurve të refuzohet, ndërsa aktgjykimi ankimor të vërtetohet dhe paditëses t'i njihen shpenzimet e procedurës.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 (pika e) dhe 201 (pika b), të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesat e të paditurve janë të pathemelta

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësja Sh.A. nga Ferizaji, në gjykatën e shkallës së parë, ka ushtruar padi me datë 30.01.1996, kundër të paditurve Sh., J., L., K., Z. dhe S.G. që të gjithë nga Ferizaji, duke kërkuar vërtetimin e pronësisë së përbashkët të fituar me punë gjatë rrjedhjes së bashkësisë jashtë martesore dhe ndarjen e pjesës së pasurisë që i takon paditëses pas vdekjes të ndjerit V.G., ku procedura është udhëhequr sipas lëndës me numër C.nr.57/96. Më pastaj lënda është ripërtërirë dhe ka marrë numrin C.nr.20/2002, ndërsa gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses ka nxjerrë aktgjykimin C.nr.20/2002 të datës 23.02.2004. Gjykata e Qarkut në Prishtinë, duke vepruar sipas ankesës të të autorizuarit të paditëses me aktvendimin Ac.nr.384/2004 të datës 03.05.2005, e ka prishur aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Ferizaj C.nr.20/2002 të datës 23.02.2004 dhe lëndën e ka kthyer gjykatës së shkallës së parë në rivendosije.

Në rishqyrtim të çështjes, pasi që gjykata e shkallës së parë ka ndërmarrë veprimet procedurale për të vepruar sipas vërejtjeve të gjykatës së shkallës më të lartë dhe pas marrjes së provave të propozuara, paditësja përmes përfaqësuesit të autorizuar, me parashtrësën e datës 27.02.2018, e ka precizuar kërkesëpadinë në kuptimin subjektiv të saj, ndaj të paditurve Gj., V., L., V. dhe V.G. që të gjithë nga Ferizaji, dhe në aspektin objektiv, me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se paditësja me tani të ndjerin V.G. kanë bashkëjetuar që nga viti 1968 se kjo bashkësi ka zgjatur gjer në vitin 1995, për 27 vite, dhe se gjatë kësaj periudhe ka punuar dhe ka kontribuar duke krijuar dhe shtuar pasurin dhe atë: në palujtshmërin ng.kad.nr..., në sip. 670 m² ZK P., Komuna Ferizaj, lokali i ndërtuar mbi kafene në sipërfaqe prej 55 m², së bashku me aneksin e saj biliardi në sip.30 m², që gjenden në rrugën ..., ng.kad.nr... ZK Ferizaj, si dhe palujtshmëria e blerë në vitin 1985 ng.kad.nr..., në sip.492 m² ZK Ferizaj, të gjitha me nga 1/2 e pasurisë së palujtshme.

Gjykata e shkallës së parë pas mbajtjes së shqyrtimeve gjyqësore, në seancën e shqyrtimit kryesor të çështjes ka administruar provat si: procesverbali i dt.10.01.2012, vërtetimi i dt.12.12.2011 në emër të paditëses, kontrata e punës në emër të paditëses e dt.20.01.1981, vendimi i dt.10.01.1982 në emër të paditëses, ekspertiza e ekspertit vlerësues të palujtshmërive M.M. e dt.06.07.2018, ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë A.H. e dt.23.05.2018, vendimi në emër të punëtores Sh.A. dt.15.02.1990, qertifikata e vdekjes në emër të V.G. dt.16.11.1995, kontrata e punës e lidhur në mes të J.G. dhe Sh.A. e dt.26.02.1990, procesverbali i dt.05.10.1998, procesverbali i dt.16.10.1997, procesverbali dt.11.03.1990, qertifikata e bashkësisë familjare dt.01.11.1996, aktvendimi nr.05-351-228 dt.25.04.1980 i KK Ferizaj, qertifikata e biznesit në

emër të V.G. me nr.08-437-03/163 dt.21.11.1989, dhe ka nxjerrë aktgjykimin C.nr.367/17 të datës 08.10.2018, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar ka theksuar se: pas shtjellimit dhe vlerësimit të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, ka ardhur në përfundim se paditësja në familjen e tani të ndjerit V.G., gjatë periudhës së bashkëjetesës jashtëmartesore që nga viti 1968 deri në vitin 1995, si punëtore shankiste në kafiteri si dhe në shtëpi e angazhuar në kryerjen e punëve shtëpiake të amvisërisë, përkujdesjen ndaj burrit dhe anëtarëve të tjerë të familjes për 10 vjet vite sa kanë jetuar në bashkësi ekonomike dhe pas ndarjes nga kjo bashkësi ekonomike, deri në vdekjen e tani të ndjerit V.G., e ka vlerësuar kontributin e saj në shtimin e pasurisë e cila sipas ekspertit për vlerësimin e palujtshmërive tani ka vlerën prej 629,906.00 €, dhe në përpjesëtim me ½ për kontributin e paditëses dhe tani të ndjerit V.G., në vlerë prej 314,953.00 €. Kjo përllogaritje e kontributit të saj është bërë duke marrë për bazë të ardhurat personale të paditëses si shankiste dhe punët e kryera si amvise të shtëpiake e V., sipas viteve dhe muajve të periudhës kontestuese sipas Agjensionit të Statistikave të Kosovës, bazë vlerësues e kontributit bruto të paditëses në familjen e përbashkët me të paditurin, të cilin kontribut duke e reduktuar në 1/3 sa do të shpenzonte për veshë mbathje, ushqim e gjëra tjera, kontributi i saj neto gjatë periudhës së bashkëjetesës do të arrinte shumën prej 104,984.00 €. Gjykata vendimin e bazoi në dispozitat ligjore nga neni 54 dhe 55 të Ligjit për Familjen i Kosovës, të parapara edhe me nenin 324 dhe 314 të Ligjit të vjetër të Familjes. Vendimin mbi shpenzimet procedurale, gjykata e shkallë së parë e ka mbështetur në nenin 450.1 të LPK-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata e Apelit vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 181 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu ky aktgjykim nuk është i përfshirë as me shkelje të tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i kanë pretenduar palët ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palëve ndërgjyqës për shkeljet që i referohen konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, e as shkeljeve tjera të pretenduara me ankesë nga neni 182 par.2, pika g), i) dhe n) të LPK-së, pasi që arsyetimi i aktgjykimit është në përputhje me dispozitën e nenit 160, par.4 dhe 5 të LPK-së, meqë gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet e çështjes, provat që i ka shfrytëzuar për vërtetimin e fakteve dhe vlerësimin e tyre. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaftë i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke bërë kështu që dispozitivi dhe arsyetimi, si dy pjesë përbërëse të aktgjykimit, të jenë në harmoni logjike dhe juridike me njëra tjetrën. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë, e në lidhmëni me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Në këtë kontest, në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket

besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre. Kështu, gjykata e shkallës së parë, në arsyetim të aktgjykimit ka paraqitur arsye të mjaftueshme për bazën juridike të kërkesëpadisë dhe shumën e aprovuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se e drejta materiale është aplikuar në mënyrë të drejtë nga gjykata e shkallës së parë, ku me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditëses, aktgjykimin e ka bazuar në dispozita konkrete ligjore që i referohen çështjes e cila është objekt i këtij kontesti në rastin konkret, duke u bazuar drejtë në dispozitën nga 324 i Ligjit për Martesën dhe Marrëdhëniet Familjare, dhe i përmbajtur edhe në nenin 54 paragrafi 1, i Ligji për Familjen i Kosovës, me të cilën përcaktohet se: *''Nëse nuk arrihet marrëveshja në kohën kur pjesa e secilit prej bashkëshortëve i takon pasurisë së përbashkët, ajo duhet të vendoset nga gjykata. Vendimi duhet të bazohet në kontributin e bashkëshortëve, përmes vlerësimit të të gjitha rrethanave dhe jo duke marrë parasysh vetëm të ardhurat personale dhe të hyrat e tjera të secilit bashkëshort, por edhe ndihmën e njërit prej bashkëshortëve të ofruar bashkëshortit tjetër, si kujdesin për fëmijët, udhëheqjen e punëve të shtëpisë, përkujdesjen dhe mirëmbajtjen e pasurisë si dhe çfarëdo forme tjetër të punës dhe të bashkëpunimit lidhur me administrimin, mirëmbajtjen dhe shtimin e pasurisë së përbashkët''*. Sepse nga provat të cilat gjenden në shkresa të lëndës është vërtetuar se paditësja në biznesin të cilin e ka udhëhequr tani i ndjeri V.G., ka punuar sipas kontratës së punës e lidhur me datë 20.01.1981, në mes të paditëses si punëmarrëse dhe V.G. si punëdhënës, e pasuar me kontratën e punës e lidhur në mes të J.G. në cilësi të punëdhënësit dhe Sh.A. në cilësi të punëmarrësit e datës 26.02.1990, ndërsa nga deklarimet e dëshmitarëve është vërtetuar se paditësja ka punuar që nga viti 1968 në kafene si shankiste dhe në udhëheqjen e lokalit, këtë e kanë vërtetuar pjesërisht edhe të paditurit.

Ndërsa me dispozitën e nenit 314 i Ligjit për Martesën dhe Marrëdhëniet Familjare, i përmbajtur në nenin 58 paragrafi 2, i Ligji për Familjen i Kosovës, përcaktohet se: *''Pasuria e fituar gjatë bashkësisë faktike (bashkësisë jashtëmartesore) dhe e cila pasuri i nënshtrohet ndarjes ose pjesëtimit, konsiderohet pasuri e përbashkët''*. Andaj, neni 58, i LFK, shprehimisht këtë lloj të pasurisë të fituar gjatë bashkësisë jashtë martesore e përkufizon si pronësi e përbashkët e bashkëjetuesve dhe nuk lejohet të ndryshohet me marrëveshje natyra juridike e pasurisë së përbashkët, por kjo pasuri e përbashkët e bashkëshortëve mund të ndahet në çdo kohë, pra si gjatë bashkëjetesës ashtu edhe pas shkëputjes së saj. Pasuria e përbashkët e bashkëshortëve mund të fitohet vetëm gjatë ekzistimit të martesës-bashkëjetesës, respektivisht nga momenti i themelimit deri në momentin e ndërprerjes së saj. E që në këtë rast, paditësja me prova konkrete e ka vërtetuar një gjë të tillë të fitimit dhe shtimit të pasurisë gjatë kohës sa ka bashkëjetuar me tanë të ndjerin V.G. gjatë rrjedhjes së bashkëjetesës së tyre nga viti 1970 deri në vitin 1995 kur edhe ka ndërruar jetë. Andaj, në rastin konkret në kuptim të këtij neni, llogaritja e kontributit të paditëses në familje mund të konsiderohet pasuri e përbashkët, pasi që të njëjtët me këtë kontribut (me të holla) e kanë fituar atë pasuri të përbashkët gjatë bashkëjetesës me tani të ndjerin Vehbi dhe gjer në vdekjen e tij.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të gabuar i ka zbatuar dispozitat ligjore të cekura si më lartë, duke pasur parasysh kohën e pretenduar me padi të paditëses për bashkësinë jashtëmartesore që ka pasur me të ndjerin V.G., sepse gjykata në

mënyrë analoge i është referuar edhe dispozitave materiale nga neni 314 dhe 324 të Ligjit të vjetër për Martesën dhe Marrëdhëniet Familjare, andaj në këtë aspekt, Kolegji, vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë është thirrë edhe në dispozitat e ligjit material që duhej të zbatohesh, marrë për bazë kohën e paraqitjes së padisë.

Në mes të palëve ndërgjyqës nuk ka qenë kontestuese fakti se paditësja që nga viti 1968 ka qenë e punësuar në lokal-in-kafenenë e tani të ndjerit V.G., po ashtu nuk ishte kontestuese se paditësja që nga viti 1970 ka krijuar bashkësinë jashtëmartesore me tani të ndjerin V. nga e cila bashkësi nuk kishin fëmijë të përbashkët, sikundër që nuk ishte kontestuese se i ndjeri V. nuk e kishte shkëputur asnjëherë bashkësinë martesore me bashkëshorten e tij të paditurën Sh.G., me të cilën kishin fëmijë të përbashkët. Kontestuese në mes të palëve ndërgjyqës ishte fakti se a kishte kontribuar paditësja në krijimin dhe rritjen e pasurisë së përbërë si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar dhe se a i takon ky kontribut sipas Ligjit për Trashëgimin.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të autorizuarit të paditurve av.A.D. se padisë së paditëses i mungon baza juridike dhe se gjykata vendimin e ka bazuar në dispozita të cilat rregullojnë raportet në mes të bashkëshortëve dhe të një martese të njohur ligjërisht, duke u bazuar edhe në Ligjin për Trashëgimi (GZ e KSAK) se paditësja nuk mund të trashëgojë pjesë të trashëgimisë të tani të ndjerit V.G., sepse nuk janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 5 i këtij ligji, duke vlerësuar se janë pretendime të pabazuar dhe të paargumentuar për faktin se paditësja me padinë e ushtruar nuk ka kërkuar ndarjen e pasurisë në bazë të trashëgimisë, po ndarjen e pasurisë në bazë të bashkëjetesës me të ndjerin dhe familjen e tij, kontributin e saj në shtimin e pasurisë përgjatë periudhës kohore sa i ndjeri V.G. ka zhvilluar biznesin e tij në të cilin ka punuar edhe paditësja sipas kontratës së punës, dhe së bashku edhe me anëtarët e tjerë të familjes së tij, duke mundësuar kështu që gjatë atyre viteve të blihen pronat dhe të shtohen anekset e lokalit dhe të kafenes ku ka punuar edhe paditësja

Nga të gjitha këto që u parashtruan më lartë, rezulton se, nuk qëndrojnë thëniet ankimore të parashtruar nga ana e palëve të paditura dhe thëniet ankimore kanë mbetur vetëm në nivel të pretendimeve siç është pretendimi ankimor për shkelje nga neni 182.1 pika g) të LPK-së, lidhur me dispozitat materiale të Ligjit mbi Trashëgimin, sepse në rastin konkret paditësja me kërkesë padi nuk ka kërkuar ndarjen e pasurisë në bazë të trashëgimisë pas vdekjes të ndjerit V.G., por se ka kërkuar në që të vërtetohet kontributi i saj në krijimin e asaj pasurie përgjatë viteve sa ka ekzistuar bashkësia jashtëmartesore me tani të ndjerin, sepse nuk ishte kontestuese se martesë me të paditurën Sh.G. nuk ishte zgjidhur asnjëherë, por se ishte zgjedhja e të ndjerit V. që të kishte një martesë dhe një bashkëjetesë, sepse dispozitat materiale ligjore nuk bëjnë ndarje në mes të martesës dhe bashkëjetesës sa i përket ndarjes së pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve, në rastin konkret paditësja gjatë periudhës sa ka bashkëjetuar me të ndjerin V.G., ka përmbushur kushtin ligjor për të kërkuar që ti njihet kontributi në pasurinë e regjistruar të të ndjerit e cila është në disponim të lejueshëm të të paditurve dhe nuk ka kurrfarë kufizimesh sipas ligjit.

Andaj, në kuptim të nenit 58 par.2 i Ligji për Familjen i Kosovës, Gjykata e Apelit vlerëson se me rastin e ndarjes së pasurisë së përbashkët, gjykata duhet të vlerësojë pasurisë e përbashkët të bashkëshortëve të krijuar gjatë jetës së përbashkët. Edhe pse në këto raste është shumë e vështirë

të përcaktohet pjesa e fituar që quhet pjesë e pasurisë së përbashkët me punën e tyre gjatë martesës. Prandaj, në rastin konkret, kontributi i paditëses duke i llogaritur kujdesin ndaj lokalit-kafenesë, mirëmbajtjen e biznesit të të ndjerit V.G. mund të vije në shprehje sepse ky kontribut i vlerësuar nga ana e ekspertit vlerësues ka ndikuar në krijimin e pasurisë së përbashkët, pasi që paditësja, gjatë kësaj kohe ka ndihmuar (kontribuar) që bashkërisht me të ndjerin Vehbi të jetojnë një jetesë me standarde të mira dhe të shtojnë pasurin e përcaktuar si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar.

Në këtë rast për Gjykatën e Apelit, ekspertiza e ekspertit vlerësues M.M. e dt.06.07.2018, në pjesën ku ka dhënë mendimin e tij, mund të merret për bazë pasi që ka vlerësuar pasurin e të nderit V.G., duke caktuar çmimin real të tregut të palujtshmërive objekt i këtij kontesti, e të cilat janë blerë, krijuar dhe shtuar përgjatë rrjedhjes së bashkëjetesës në mes të paditëses dhe të ndjerit V.G. me familjen e tij, ndërsa që gjykata me rastin e caktimit të vlerës së kontributit të paditëses në shtimin e kësaj pasurie për bazë ka marrë të ardhurat personale të paditëses si shankiste dhe punët e kryera në amvisëri në shtëpinë e V. sipas viteve dhe muajve të periudhës kontestuese, që sipas Agjencionit të Statistikave të Kosovës bazë vlerësuese e kontributit bruto të paditëses në familjen e përbashkët me të paditurit, duke e reduktuar shumën e caktuar nga ana e ekspertit vlerësues në 1/3 sa do të shpenzonte paditësja për veshmbathje, ushqim e të tjera, ka vlerësuar vlerën e kontributit të paditëses gjatë periudhës së bashkëjetesës se i takon e drejta paditëses për kompensim që një veprim i tillë është në kompetencë të gjykatës për të vlerësuar të drejtën e paditëses, pasi që eksperti me ekspertizën e tij të datës 06.07.2018, ka konstatuar se: “ *prona objekt i këtij vlerësimi, aktualisht ka alternativa të shfrytëzimit në të ardhmen me pretendim të realizimit të fitimit sa më të mirë të mundshëm*”, ashtu që ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses duke i detyruar të paditurit t’ia kompensojnë neto shumën prej 104,984.00 euro. Andaj, një konstatim i tillë është i pranueshëm për gjykatën e Apelit, pasi që ekspertiza vlerësuese ka përmbajtë elementet e nevojshme të dhëna mbi bazën e njohurive profesionale dhe arsye të mjaftueshme të cilat gjykata i vlerësoi si të drejta për vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje kontestimore, e në këtë drejtim edhe nga palët ndërgjyqës nuk ka pasur propozim për ekspertizë të re.

Pjesëtimi i pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve në këtë mënyrë është parim themelor i Ligjit për Familjen, pasi që asnjëri nga bashkëshortët nuk mundet që në mënyrë arbitrare të privohet nga pasuria e tij, parim ky i garantuar me Kushtetutën e Kosovës dhe Konventa Ndërkombëtare (neni 52 i LFK).

Ndërsa me Ligjin mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore (GZ RSFJ 30.01.1980) në nenin 16 është përcaktuar: ‘ *se bashkëpronari ka të drejtë të kërkoj në çdo kohë pjesëtimin e sendit, përveç në kohën kur ky pjesëtim do të ishte në dëm të bashkëpronarëve të tjerë, po qe se me ligj nuk është caktuar ndryshe* ’.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat pretendime nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit ka vendosur sikurse në pikën II. të këtij aktgjykimi, pasi që pika I dhe III e aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i përgjithshëm C.nr.367/2017, i datës 08.10.2018, e cila ka të bëjë me pjesën e vërtetuar të pasurisë së të ndjerit V.G. dhe pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë së paditëses, nuk ka qenë objekt ankimi në këtë procedurë.

Nga të gjitha arsyet e cekura në arsyetim të këtij aktgjykimi të shkallës së dytë, Gjykatës së Apelit i rezulton se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga nenet 194, 195 paragrafi 1 pika (d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.346/2019, me datë 30.04.2024

Kryetare e kolegjit
Naime Ahmeti, d.v